

**FJALIM NGA CAROLINE ZIADEH, PËRFAQËSUESE SPECIALE E
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEFE E UNMIK-ut
DEBATI NË KËSHILLIN E SIGURIMIT PËR UNMIK-un**

Nju Jork

30 TETOR 2024

Ju falmnderit Presidente. Nëse më lejoni, Kisha dashur të ju përgëzoj juve dhe shtetin tuaj Zvicrën, si dhe ekipin tuaj, për udheheqësinë gjatë këtij muaji.

Zonja Presidente, të nderuar shkëlqesi,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Sigurimit, zonja dhe zotërinjë

1. Kam nderin të përditësoj Këshillin për zhvillimet e fundit në Kosovë që nga nxjerrja e raportit të Sekretarit të Përgjithshëm që mbulon periudhën nga 16 marsi deri më 15 shtator të këtij viti, dhe të ndaj disa vëzhgime gjithëpërfshirëse.
2. Në angazhimet e mia me zyrtarët në Beograd dhe Prishtinë dhe me palët vendase politike e civile, si dhe me partnerët ndërkombëtarë, dëgjoj, dhe po e ndaj me ju çfarë kam dëgjuar, dëgjoj një aspiratë për një dialog konstruktiv dhe marrëdhënie paqësore, edhe pse situata në terren mbetet e brishtë dhe progresi i pasigurt.
3. Gjatë vizitës sime të fundit në veri të Kosovës në shtator, organizatat e shoqërisë civile, aktorët politikë dhe banorët shprehën shqetësime serioze për ndikimin negativ të veprimeve të fundit unilaterale që prekin të drejtat e tyre ekonomike, sociale dhe politike. Ata shpjeguan se mbylljet e fundit të degëve të postës së Serbisë dhe zyrave komunale të drejtuara nga

Qeveria e Serbisë, përfshirë të fundit në Skenderaj më 16 tetor, kanë kufizuar qasjen në shërbimet kryesore, veçanërisht për komunitetin serb të Kosovës. Këto vështirësi e përkeqësuan efektin e masave të mëparshme, si rregullorja për përdorimin e dinarit dhe mbyllja e degëve të Bankës së Kursimeve (Postanska Stedionica). Këta pjesëtarë të komunitetit shprehën më tej ankth lidhur me indikacionet se autoritetet e Prishtinës mund të përpiqen të ushtrojnë kontrollin mbi institucionet arsimore dhe shëndetësore të financuara nga Serbia.

Zonja Presidente,

4. Mes diskursit në fillim të kësaj vere për rihapjen e urës së Ibrit për trafikun e automjeteve, dhe si përgjigje ndaj një numri në rritje të arrestimeve të serbëve të Kosovës për shkelje të supozuara të rendit publik, ne kemi vërejtur një rritje të dukshme të aktivizmit qytetar në veri të Kosovës, duke përfshirë edhe në mesin e grupeve të grave dhe studentëve të universitetit. Në këtë drejtim, më duhet të shpreh shqetësimin lidhur me arrestimet e individëve për ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes dhe tubimit.
5. Javët e fundit, ka pasur një sërë pretendimesh për përdorim të tepruar të forcës dhe keqtrajtim nga policia gjatë arrestimeve dhe paraburgimit policor në veri të Kosovës. Tashmë janë duke vazhduar hetimet nga Inspektorati Policor i Kosovës lidhur me këto pretendime. Bërja publike e gjetjeve të Inspektoratit pasi të përfundohet, mund të jetë një hap i dobishëm drejt ndërtimit të besimit tek institucionet. Këtu, po theksoj që para pak minutash, Inspektorati sapo ka rekomanduar suspendimin e dy zyrtarëve policor të përfshirë në ndalimin e Serbit të Kosovës në Sheshin Shën Llazar më 26 tetor.

Zonja Presidente,

6. Avancimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut është thelbi i misionit tonë në Kosovë. Në sfondin e zhvillimeve të fundit, forcimi i masave për promovimin e mëtejshëm të barazisë dhe mosdiskriminimit janë thelbësore, veçanërisht mbrojtja e të drejtave pronësore, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe respektimi i plotë i të drejtave gjuhësore të të gjitha komuniteteve. I mirëpres përpjekjet e Ombudspersonit për t'u angazhuar me komunitete të ndryshme dhe inkurajoj atë dhe ekipin e tij që të vazhdojnë të përmbushin mandatin e tyre në mënyrë të pavarur.
7. Unë gjithashtu mirëpres disa përparime të bëra kohët e fundit nga Grupi i punës për personat e zhdukur dhe përpjekjet e vazhdueshme për të përmbushur pritshmëritë e familjeve, pikëllimi i vazhdueshëm i të cilave rëndon shumë kohezionin social.

Zonja Presidente,

8. Një vit që nga incidenti i rëndë i sigurisë në Banjska, vazhdoj të bëj thirrje për përgjegjësi të menjëhershme për autorët përmes proceseve gjyqësore të plota, të drejta, transparente dhe të pavarura, të cilat janë thelbësore për nxitjen e stabilitetit. Një akt i tillë dhune është i papranueshëm dhe nuk duhet të përsëritet. Lidhur me këtë, vërejmë se seanca fillestare për këtë rast është mbajtur më 9 tetor në Gjykatën themelore të Prishtinës kundër tre të pandehurve që janë në paraburgim, nga gjithsej 45 të akuzuarit në aktakuzë, të cilët përballen me një sërë akuzash, duke përfshirë terrorizmin.

Zonja Presidente,

9. Kryenegociatorët u takuan në Bruksel të enjten e kaluar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Vendimi për krijimin e një grupi punues për të lehtësuar hyrjen e produkteve të caktuara që prishen lehtësisht dhe avancimi i ndërlidhjes energjetike janë zhvillime të mirëseardhura. Është thelbësore të intensifikohen përpjekjet për të arritur rezultate konkrete në dialogun e ndërmjetësuar nga BE. Ky dialog, të cilin ne e mbështesim fuqishëm, mbetet qendror për zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura, duke përfshirë themelimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Suksesi do të arrihet përmes qasjeve konstruktive, të hapura dhe respektimit të marrëveshjeve të arritura me vështirësi të krijuara gjatë disa viteve. Unë besoj se të dyja palët e pranojnë se përparimi kuptimplotë drejt rezultateve vendimtare politike duhet të ndërtohet mbi besimin e fituar nga realizimi i qëllimeve të arritshme. Në këtë drejtim, mirëpres qëndrimin e kujdesshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me mbajtjen e derës së hapur për kthimin e mundshëm të gjyqtarëve serbë të Kosovës, në përputhje me marrëveshjet e qëndrueshme të ndërmjetësuara nga BE-ja.

Zonja Presidente,

10. Heqja e ndalimit për hyrjen e mallrave nga Serbia më 8 tetor, shoqëruar me konsensus mbi procedurat e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, rezultoi në nëntë marrëveshje që synonin nxitjen e prosperitetit ekonomik rajonal. Mallrat serbe tani kanë rifilluar hyrjen në Kosovë. Është domosdoshmëri që pengesat aktuale të adresohen me shpejtësi. Ky përparim i kohëve të fundit vë në pah potencialin për punë më të thellë drejt

integritet rajonal nëpërmjet kompromiseve konstruktive diplomatike dhe konsensusit.

11. Lëshimi i parashikuar i fondeve fillestare nga plani i rritjes, pas miratimit të agjendave të reformave nga Komisioni Evropian, i prezantuar nga qeveritë në Ballkanin Perëndimor, inkurajon momentumin për të avancuar dhe forcuar më tej integrimin rajonal dhe bashkëpunimin.

Zonja Presidente,

12. Ndërtimi i besimit në të gjitha nivelet mbetet gurthemeli i një të ardhmeje të përbashkët dhe më të mirë për të gjithë. Gjetjet e raportit të fundit të Indeksit të Mirëbesimit, të kryer nga një OJQ lokale si pjesë e projektit Barabar të mbështetur nga UNMIK-u, theksojnë mungesën e besimit në institucione dhe rritjen e pesimizmit për të ardhmen e besimit ndërkomunal. Megjithkëtë, thënë kjo, shumica e të anketuarve shqiptarë dhe serbë të Kosovës e shohin pajtimin si thelbësor për një të ardhme më të mirë për gjeneratat e ardhshme, duke theksuar rëndësinë, ndoshta tani më shumë se kurrë, të punës aktive të ndërtimit të besimit për të arritur përparim.
13. Rrjedhimisht, misioni ynë mbetet i përkushtuar për të nxitur përpjekjet në terren që synojnë të ndërtojnë besim në të gjitha komunitetet, duke përfshirë në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit, grave, paqes dhe sigurisë, si dhe rinisë, paqes e sigurisë.
14. Si pjesë e angazhimit tonë për të inkurajuar pjesëmarrjen kuptimplote të grave dhe të rinjve në proceset politike, UNMIK-u së fundi ka mbështetur

diskutimet e nivelit të lartë për promovimin e barazisë gjinore brenda dialogut. Këto shkëmbime prodhuan rekomandime specifike për qeverisjen dhe vendimmarrjen përfshirëse gjinore. Përveç kësaj, duke u bazuar në organizimin e suksesshëm të Asamblesë së 6-të Rajonale Rinore të OKB-së, 130 delegatë të rinjve lokalë dhe rajonalë morën pjesë në konferencën "Rinia, paqja dhe siguria në epokën e IA-së", që u mbajt në Kosovë në maj 2024. UNMIK-u vazhdon të organizojë punëtori për të pajisur të rinjtë nga komunitete të ndryshme në Kosovë me aftësi për të luftuar keqinformimin dhe dezinformimin.

Zonja Presidente,

15. Me afrimin e shpejtë të periudhës së fushatës parazgjedhore, është thelbësore që liderët politikë dhe të gjithë sektorët e shoqërisë të krijojnë një mjedis ku votuesit të ndjehen të sigurt, të angazhuar dhe të sigurt se pjesëmarrja, nga të gjitha komunitetet, duke përfshirë komunitetin Serb në veri - mund të çojë në rezultate domethënëse. Kjo nënkupton sigurimin e ushtrimit paqësor të së drejtës së votës si element i së drejtës për të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike. Do të thotë gjithashtu sigurimi i kushteve për pjesëmarrje të gjerë, të arritshme vetëm kur njerëzit ndihen të sigurt, të respektuar dhe të fuqizuar.

Zonja Presidente,

16. Muajin e kaluar të gjithë ju u mblodhën në Këshin e Sigurimit gjatë javës së nivelit të lartë të Asamblesë së Përgjithshme të këtij viti, liderët botërorë

gjatë javës së përmendur theksuan nevojën për veprim kolektiv për të promovuar paqen, zhvillimin e qëndrueshëm dhe dinjitetin njerëzor – të gjitha ato vlera që kanë një rëndësi të thellë në Kosovë dhe në rajon. Vlerat e tilla janë në rrezik nëse ndërmerren veprime që kërcënojnë të drejtat, liritë dhe mjetet e jetesës në mesin e komuniteteve të ndryshme. Prandaj, nga ky Këshill, u bëj thirrje të gjitha palëve që të dëgjojnë në mënyrë të barabartë thirrjen e Sekretarit të Përgjithshëm për udhëheqje të përgjegjshme, për të siguruar që këto vlera të përbashkëta të ruhen në frymë dhe në praktikë.

Para se të përfundoj, Zonja Presidente,

17. Më lejoni të vlerësoj kontributet e rëndësishme të komandantit në largim të Forcës së Kosovës, gjeneral Özkan Ulutaş, udhëheqja e të cilit ishte e rëndësishme në menaxhimin e krizave të ndryshme. Gjithashtu mirëpres ngrohtësisht pasardhësin e tij, gjeneralin Enrico Barduani, me të cilin pres të punoj ngushtë.

Zonja Presidente,

18. U bëj thirrje anëtarëve të Këshillit të Sigurimit që të qëndrojnë të palëkundur në përkushtimin e tuaj për paqen, stabilitetin dhe bashkëpunimin në Kosovë, dhe shpreh vlerësimin tim të thellë për mbështetjen tuaj të vazhdueshme ndaj UNMIK-ut. Duke punuar së bashku, ne mund të ndihmojmë për të nxitur dialogun politik konstruktiv, për të mbrojtur të drejtat themelore dhe për të promovuar siguri dhe prosperitet më të qëndrueshëm për të gjithë dhe ju falenderoj.